Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 12
Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me interesat në njësitë e tjera ekonomike

Objektivi

1 **Objektivi i këtij SNRF-je është të kërkojë nga një njësi ekonomike që të japë informacione shpjeguese, që u mundësojnë përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë:**

(a) natyrën dhe rreziqet e lidhura me *interesat e saj në njësitë e tjera ekonomike*; dhe

(b) efektet e këtyre interesave mbi pozicionin e saj financiar, performancën financiare dhe flukset e mjeteve monetare.

Realizimi i objektivit

2 Për të arritur objektivin në paragrafin 1 një njësi ekonomike do japë informacione shpjeguese:

(a) gjykimi më i rëndësishëm dhe hamendësimet janë bërë në përcaktimin:

(i) e natyrës së interesit të saj në një njësi tjetër ekonomike ose në marrëveshje;

(ii) e tipit të marrëveshjes së përbashkët në të cilën ka një interes (paragrafët 7–9);

(iii) që ajo plotëson përkufizimin e një njësie ekonomike investuese, në qoftë se është e aplikueshme (paragrafi 9A); dhe

(b) mbi interesat e saj në:

(i) filialet(paragrafët 10–19);

(ii) marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet(paragrafët 20–23); dhe

(iii) *njësitë ekonomike të strukturuara* që nuk janë të kontrolluara nga njësia ekonomike (njësitë ekonomike të strukturuara e të pa konsoliduara) (paragrafët 24-31).

3 Nëse dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ky SNRF, së bashku me dhënien e informacioneve shpjeguese të kërkuara nga SNRF-të e tjera, nuk realizon objektivin në paragrafin 1, një njësi ekonomike jep shpjegime për çdo informacion shtesë që është i nevojshëm për realizimin e këtij objektivi.

4 Një njësi ekonomike do të ketë parasysh nivelin e detajeve të nevojshme për të plotësuar objektivin e dhënies së informacionit shpjegues dhe faktin sesa rëndësi duhet t'i kushtojë secilës prej kërkesave të këtij SNRF-je. Ajo do të japë informacion shpjegues në total ose të shkëputur në mënyrë që informacioni i dobishëm të mos bëhet i pakuptueshëm as nga përfshirja e një sasie të madhe hollësirash të parëndësishme, as nga totalizimi i zërave që kanë karakteristika të ndryshme (shih paragrafët B2–B6).

Objekti

5 Ky SNRF do të zbatohet nga një njësi ekonomike që ka një interes në ndonjë nga këto më poshtë:

(a) filiale

(b) marrëveshje të përbashkëta (d.m.th. veprimtari të përbashkëta ose sipërmarrje të përbashkëta)

(c) pjesëmarrje

(d) njësitë ekonomike të strukturuara të pakonsoliduara.

5A Me përjashtim sa përshkruhet në paragrafin B17, kërkesat në këtë SNRF zbatohen për interesat e një njësie ekonomike të renditura në paragrafin 5, që janë klasifikuar (ose të përfshira në një grup të nxjerrë jashtë përdorimit që është klasifikuar) si i mbajtur për shitje ose si operacione jo të vijueshme në përputhje me SNRF 5 *Aktivet afatgjata të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera*.

6 Ky SNRF nuk do të zbatohet për:

(a) skemat e përfitimit pas-punësimit apo përfitimet e tjera afatgjata të punonjësve për të cilat zbatohet SNK 19 *Përfitimet e punonjësve.*

(b) pasqyrat financiare individuale të një njësie ekonomike për të cilat zbatohet SNK 27 *Pasqyrat financiare individuale.* Megjithatë:

(i) nëse një njësi ekonomike ka interesa në njësi ekonomike të strukturuara të pa konsoliduara dhe përgatit pasqyrat financiare individuale si të vetmet pasqyra financiare të saj, ajo do të zbatojë kërkesat në paragrafët 24-31, kur përgatit këto pasqyra financiare individuale.

(ii) një njësi ekonomike investuese që përgatit pasqyra financiare në të cilat të gjitha filialet e saj janë matur me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me paragrafin 31 të SNRF 10 do të paraqesë informacionet shpjeguese për njësitë ekonomike investuese të kërkuara nga ky Standard.

(c) një interes të mbajtur nga një njësi ekonomike që merr pjesë, por nuk ka kontroll të përbashkët, në një marrëveshje të përbashkët, përveçse kur ky interes rezulton me një ndikim të rëndësishëm mbi marrëveshjen apo është një interes në një njësi ekonomike të strukturuar.

(d) një interes në një njësi tjetër ekonomike, që trajtohet në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet financiare.* Megjithatë, një njësi ekonomike do ta zbatojë këtë SNRF:

(i) kur ky interes është një interes në një pjesëmarrje ose në një sipërmarrje të përbashkët, që matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, në përputhje me SNK 28 *Investimet në pjesëmarrjet dhe sipërmarrjet e përbashkëta;* ose

(ii) kur ky interes është një interes në një njësi ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar.

Gjykimet dhe supozimet e rëndësishme

7 Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese në lidhje me gjykimet dhe supozimet e rëndësishme që ka bërë (dhe ndryshimet në këto gjykime dhe supozime) në përcaktimin:

(a) që ajo ka kontrollin e një njësie tjetër ekonomike, pra të një të investuari, siç është përshkruar në paragrafët 5 dhe 6 të SNRF 10 *Pasqyrat financiare të konsoliduara*;

(b) që ajo ka kontrollin e përbashkët të një marrëveshjeje ose influencë të konsiderueshme mbi një njësi tjetër ekonomike; dhe

(c) llojin e marrëveshjes së përbashkët (d.m.th. veprimtarinë e përbashkët ose sipërmarrjen e përbashkët), kur marrëveshja është strukturuar përmes një mekanizmi financiar të veçantë.

8 Gjykimet dhe supozimet e rëndësishme të shpjeguara në përputhje me paragrafin 7 përfshijnë ato që bëhen nga njësia ekonomike, kur ndryshimet në faktet dhe rrethanat janë të tilla që përfundimi, nëse ajo ka kontroll, kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme, ndryshon gjatë periudhës raportuese.

9 Në përputhje me paragrafin 7, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues, për shembull, për gjykime të rëndësishme dhe supozime të bëra në përcaktimin se:

(a) ajo nuk kontrollon një njësi tjetër ekonomike, edhe pse zotëron më shumë se gjysmën e të drejtave të votës të njësisë tjetër.

(b) kontrollon një njësi tjetër ekonomike edhe pse ajo zotëron më pak se gjysmën e të drejtave të votës të njësisë tjetër ekonomike.

(c) ajo është një agjent apo njësia kryesore (shih paragrafët B58–B72 të SNRF 10).

(d) ajo nuk ka influencë të konsiderueshme, edhe pse ajo zotëron 20 për qind ose më shumë të drejtave të votës të një njësie tjetër ekonomike.

(e) ajo ka influencë të konsiderueshme, edhe pse zotëron më pak se 20 përqind të drejtave të votës të një njësie tjetër ekonomike.

Statusi i njësisë ekonomike investuese

9A Kur një shoqëri mëmë përcakton që është një njësi ekonomike investuese në përputhje me paragrafin 27 të SNRF 10, njësia ekonomike investuese do të japë informacione shtesë rreth gjykimeve të rëndësishme dhe hamendësimet që ka bërë në përcaktimin që ajo është një njësi ekonomike investuese. Në qoftë se njësia ekonomike investuese nuk ka një ose më shumë karakteristika tipike të një njësie ekonomike investuese (shiko paragrafin 28 të SNRF 10), ajo do të japë informacion shpjegues për arsyet konkluduese të të qenit njësi ekonomike investuese.

 © Fondacioni i SNRF-ve

9B Kur një njësi ekonomike bëhet, ose pushon së qëni njësi ekonomike investuese, ajo do të japë informacion shpjegues për ndryshimin e statusit si njësi ekonomike investuese dhe arsyet e këtij ndryshimi. Gjithashtu, një njësi ekonomike që bëhet njësi ekonomike investuese do të japë informacion shpjegues për efektet e ndryshimit të statusit në pasqyrat financiare për periudhën e paraqitur duke përfshirë:

(a) totalin e vlerës së drejtë, në ditën e ndryshimit të statusit, të filialeve që humbasin të drejtën e konsolidimit;

(b) totalin e përfitimit apo të humbjes, në qoftë se ka, të llogaritur në përputhje me paragrafin B101 të SNRF 10; dhe

(c) nënzërin (nënzërat) e fitimit ose humbjes në të cilin ky fitim ose humbje neto është njohur (nëse nuk janë paraqitur veçmas).

Interesat në filiale

10 Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të konsoliduara

(a) të kuptojnë:

(i) përbërjen e grupit; dhe

(ii) interesin që interesat jo-kontrolluese kanë në aktivitetet e grupit dhe flukset e mjeteve monetare (paragrafi 12); dhe

(b) të vlerësojnë:

(i) natyrën dhe shtrirjen e kufizimeve të rëndësishme në aftësinë e tyre për të hyrë ose përdorur aktivet, dhe për të shlyer detyrimet, e grupit(paragrafi13);

(ii) natyrën e rreziqeve, që lidhen me interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuaratë konsoliduara, dhe ndryshimet në to(paragrafët 14–17);

(iii) pasojat e ndryshimeve në interesin e saj të pronësisë në një filial, që nuk çojnë në një humbje të kontrollit(paragrafi 18); dhe

(iv) pasojat e humbjes të kontrollit të një filiali gjatë periudhës raportuese (paragrafi 19).

11 Kur pasqyrat financiare të një filiali, të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, kanë ose datën, ose periudhën të ndryshme nga ai i pasqyrave financiare të konsoliduara (shih paragrafët B92 dhe B93 të SNRF 10), një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese për:

(a) datën e përfundimit të periudhës së raportimit të pasqyrave financiare të këtij filiali; dhe

(b) arsyen e përdorimit të një date apo periudhe të ndryshme.

Interesi që interesat jo kontrolluese kanë në aktivitetet dhe flukset monetare të grupit

12 Një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese për secilin nga filialet e saj, që kanë interesa jo-kontrolluese, të cilat janë materiale për njësinë raportuese, në lidhje me:

(a) emrin e filialit.

(b) vendndodhjen kryesore të biznesit (dhe vendin e themelimit nëse është i ndryshëm nga vendndodhja kryesore e biznesit) të filialit.

(c) përqindjen e interesave të pronësisë që u përket interesave jo-kontrolluese.

(d) përqindjen e të drejtave të votës që u përket interesave jo-kontrolluese, nëse është e ndryshme nga përqindja e interesave të pronësisë.

(e) fitimin ose humbjen e caktuar për interesat jo-kontrolluese të filialit gjatë periudhës raportuese.

(f) interesat jo-kontrolluese të akumuluara të filialit në fund të periudhës raportuese.

(g) informacionin financiar përmbledhës për filialin (shih paragrafin B10).

Natyra dhe shkalla e kufizimeve të rëndësishme

13 Njësia ekonomike jep si informacion shpjegues:

(a) kufizimet e rëndësishme (p.sh. kufizime statutore, kontraktuale dhe rregullatore) mbi aftësinë e saj për të hyrë ose përdorur aktivet dhe të shlyejë detyrimet e grupit, të tilla si:

(i) ato që kufizojnë aftësinë e një shoqërie mëmë ose filialeve të saj për të transferuar mjete monetare ose aktive të tjera tek (ose nga) njësitë e tjera ekonomike brenda grupit.

(ii) garancitë ose kërkesat e tjera që mund të kufizojnë dividendët dhe shpërndarjet e tjera të kapitalit, ose huatë dhe paradhëniet e dhëna ose të paguara tek (ose nga) njësitë e tjera ekonomike brenda grupit.

(b) natyrën dhe shkallën në të cilën të drejtat mbrojtëse të interesave jo-kontrolluese mund të kufizojnë në mënyrë të konsiderueshme aftësinë e njësisë ekonomike për të hyrë ose përdorur aktivet dhe për të shlyer detyrimet e grupit (të tilla si në rastin kur një shoqëri mëmë është e detyruar të shlyejë detyrimet e një filiali para se të shlyejë detyrimet e veta, ose kur kërkohet miratimi nga interesat jo-kontrolluese ose për të hyrë në aktive, ose për të shlyer detyrimet e një filiali).

(c) vlerat kontabël neto në pasqyrat financiare të konsoliduara të aktiveve dhe detyrimeve, për të cilat zbatohen këto kufizime.

Natyra e rreziqeve që lidhen me interesat e një njësie ekonomike në njësitë ekonomike të strukturuara të konsoliduara

14 Një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese për kushtet e çfarëdo marrëveshjeje kontraktuale, sipas të cilës shoqëria mëmë ose filialet e saj kërkohet të japin mbështetje financiare për një njësi ekonomike të strukturuar të konsoliduar, duke përfshirë edhe ngjarjet apo rrethanat që mund ta ekspozojnë njësinë raportuese ndaj një humbjeje (p.sh. marrëveshje të likuiditetit ose të përcaktimit të kredisë të shoqëruara me detyrime për të blerë aktivet e njësisë ekonomike të strukturuar ose për të ofruar mbështetje financiare).

15 Nëse gjatë periudhës raportuese, një shoqëri mëmë ose ndonjë nga filialet e saj, pa pasur ndonjë detyrim kontraktual, i ka dhënë mbështetje financiare apo mbështetje tjetër një njësie ekonomike të strukturuar të konsoliduar (p.sh. duke blerë aktivet ose instrumentet e emetuara nga njësia ekonomike e strukturuar), njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për:

(a) llojin dhe madhësinë e mbështetjes së dhënë, përfshirë situatat në të cilat shoqëria mëmë ose filialet e saj kanë ndihmuar njësinë ekonomike të strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare; dhe

(b) arsyet për dhënien e mbështetjes.

16 Nëse gjatë periudhës raportuese një shoqëri mëmë ose ndonjë nga filialet e saj, pa pasur ndonjë detyrim kontraktual, i ka dhënë mbështetje financiare apo mbështetje tjetër një njësie ekonomike të strukturuar,paraprakisht të pa konsoliduar, dhe dhënia e mbështetjes çon në vendosjen e kontrollit mbi njësinë ekonomike të strukturuar, njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për faktorët përkatës që kanë çuar në marrjen e këtij vendimi.

17 Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese për synimet aktuale për t'i dhënë mbështetje financiare apo mbështetje tjetër një njësie ekonomike të strukturuar të konsoliduar, duke përfshirë synimet për të ndihmuar njësinë e strukturuar në sigurimin e mbështetjes financiare.

Pasojat e ndryshimeve në interesin e pronësisë të një shoqërie mëmë në një filial që nuk çon në një humbje të kontrollit

18 Një njësi ekonomike do të paraqesë një plan i cili tregon efektet në kapitalin neto, që u takon pronarëve të shoqërisë mëmë, të çdo ndryshimi në interesin e saj të pronësisë në një filial, që nuk çon në një humbje të kontrollit.

Pasojat e humbjes së kontrollit të një filiali gjatë periudhës raportuese

19 Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese për fitimin ose humbjen, nëse ka, të llogaritur në përputhje me paragrafin 25 të SNRF 10, dhe:

 © Fondacioni i SNRF-ve

(a) pjesën e këtij fitimi ose të humbjes në lidhje me matjen e çdo investimi, të mbajtur në filialin e mëparshëm, me vlerën e tij të drejtë, në datën kur është humbur kontrolli; dhe

(b) nënzërin (nënzërat) e fitimit ose humbjes në të cilin ky fitim ose humbje neto është njohur (nëse nuk janë paraqitur veçmas).

Interesat në filialet e pakonsoliduara (njësitë ekonomike investuese)

19A Një njësi ekonomike investuese, që në përputhje me SNRF 10, i kërkohet të aplikojë përjashtimin e konsolidimit dhe në vend të tij të llogarisë investimet e saj në një filial me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes do të japë informacione shtesë për këtë fakt.

19B Për çdo filial të pa konsoliduar, një njësi ekonomike investuese do të japë informacione shtesë:

(a) emrin e filialit;

(b) adresën kryesore të biznesit (dhe vendin ku është themeluar, në qofte se është i ndryshëm nga adresa kryesore e biznesit) të filialit; dhe

(c) përqindjen e zotërimit të interesit njësia ekonomike investuese dhe, në qoftë se është e ndryshme, përqindjen e të drejtës së votës.

19C Në qoftë se një njësi ekonomike investuese është shoqëria mëmë e një njësie tjetër investuese, shoqëria mëmë do gjithashtu që të japë informacionet shpjeguese në 19B(a)–(c) për investimet që janë të kontrolluara nga filiali i saj si si ekonomike investuese. Dhënia e informacioneve shpjeguese mund të bëhet duke përfshirë në pasqyrat financiare të shoqërisë mëmë, pasqyrat financiare të filialit (ose filialeve) që përmbajnë informacionin e mësipërm.

19D Një njësi ekonomike investuese do të japë informacion shpjegues:

(a) për natyrën dhe përmasat e kufizimeve të rëndësishme (që rezultojnë nga marrëveshjet huamarrëse, kërkesat rregulatore ose marrëveshjet kontraktuale) mbi aftësinë e një filiali të pa konsoliduar për të transferuar fonde tek njësia ekonomike investuese në formën e dividentëve në mjete monetare ose të ri paguajë hua ose paradhënie të bëra për llogari të filialit të pa konsoliduar nga ana e njësisë ekonomike investuese; dhe

(b) çdo angazhim aktual ose qëllime për të dhënë mbështetje financiare ose mbështetje në forma të tjera për një filial të pakonsoliduar, duke përfshirë angazhimet ose qëllimet për të ndihmuar filialin në marrjen e mbështetjes financiare.

19E Në qoftë se, gjatë periudhës raportuese, një njësi ekonomike investuese ose ndonjë prej filialeve të saj, që nuk kanë detyrime kontraktuale për ta bërë këtë, japin mbështetje financiare ose mbështetje në forma të tjera për një filial të pa konsoliduar (si psh. për të blerë një aktiv ose një instrument të lëshuar nga filiali ose për të ndihmuar filialin në marrjen e një mbështetje financiare), njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues:

(a) llojin dhe shumën e mbështetjes së dhënë për çdo filial të pa konsoliduar; dhe

(b) arsyet për dhënien e mbështetjes.

19F Një njësi ekonomike investuese do të japë informacion shpjegues për termat e ndonjë marrëveshje kontraktuale që mund t'i kërkojë njësisë ekonomike ose filialit të saj të pa konsoliduar të japë mbështetje financiare për një njësi ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar, të kontrolluar, përfshirë dhe rastet apo rrethanat që mund të ekspozojnë njësinë ekonomike raportuese kundrejt një humbje (si p.sh besueshmërisë në aftësinë likuiduese, përkeqësim të klasifikimit kreditues të shoqëruar me detyrimin për të blerë aktive të njësisë ekonomike të strukturuar ose të japë mbështetje financiare).

19G Në qoftë se gjatë periudhës raportuese një njësi ekonomike investuese ose ndonjë nga filialet e saj të pa konsoliduara, që nuk kanë detyrime kontraktuale për ta bërë këtë, japin mbështetje financiare ose mbështetje në forma të tjera për një njësi ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar që njësia ekonomike investuese nuk ka kontroll, dhe nëse dhënia e kësaj mbështetje ka rezultuar në atë që njësia ekonomike investuese të kontrollojë njësinë ekonomike të strukturuar, njësia ekonomike investuese do të japë informacion shpjegues dhe sqarime për faktorët përkatës që bënë të arrihej në një vendim të tillë për dhënien e mbështetjes.

Interesat në marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet

20 Një njësi ekonomike do të japë informacione shpjeguese që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare të vlerësojnë:

(a) natyrën, shtrirjen dhe efektet financiare të interesave të saj në marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet, duke përfshirë natyrën dhe efektet e marrëdhënieve të saj kontraktuale me investitorët e tjerë, me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme, mbi marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet (paragrafët 21 dhe 22); dhe

(b) natyrën e rreziqeve, që lidhen me interesat e saj në sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet, dhe ndryshimet në to, (paragrafi 23).

Natyra, shtrirja dhe efektet financiare të interesave të një njësie ekonomike në marrëveshjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet

21 Njësia ekonomike jep si informacion shpjegues:

(a) për çdo marrëveshje të përbashkët dhe pjesëmarrje që është materiale për njësinë raportuese:

(i) emrin e marrëveshjes së përbashkët ose të pjesëmarrjes.

(ii) natyrën e marrëdhënies së njësisë ekonomike me marrëveshjen të përbashkët ose pjesëmarrjen (për shembull, duke përshkruar natyrën e aktiviteteve të marrëveshjes së përbashkët ose të pjesëmarrjes dhe nëse janë strategjikë për aktivitetet e njësisë ekonomike).

(iii) vendin kryesor të biznesit (dhe vendin e themelimit, në rastin kur ndryshon nga vendi bazë i zhvillimit të biznesit) të marrëveshjes së përbashkët ose pjesëmarrjes.

(iv) përqindjen e interesit të pronësisë ose pjesën e pjesëmarrjes të zotëruar nga njësia ekonomike dhe, nëse është e ndryshme, përqindjen e të drejtave të votës që ka (nëse është e mundur).

(b) për çdo sipërmarrje të përbashkët dhe pjesëmarrje që është materiale për njësinë raportuese:

(i) nëse investimi në sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrjen matet duke përdorur metodën e kapitalit neto ose me vlerën e drejtë.

(ii) informacion përmbledhës financiar në lidhje me sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrjen, siç është specifikuar në paragrafët B12 dhe B13.

(iii) për vlerën e drejtë të investimit të saj në sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrjen, nëse ka një çmim të kuotuar tregu për të, kur sipërmarrja e përbashkët ose pjesëmarrja kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto.

(c) informacion financiar, siç specifikohet në paragrafin B16, rreth investimeve të njësisë ekonomike në sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet, që nuk janë individualisht materiale:

(i) në total për të gjitha sipërmarrjet e përbashkëta individualisht jomateriale si dhe në mënyrë të veçantë,

(ii) në total për të gjitha pjesëmarrjet individualisht jomateriale.

21A Një njësi ekonomike investuese nuk i kërkohet të japë informacione shpjeguese sipas paragrafëve 21(b)-21(c).

22 Gjithashtu, njësia ekonomike duhet të japë informacion shpjegues:

(a) për natyrën dhe shkallën e çdo kufizimi të rëndësishëm (p.sh. që rrjedh nga marrëveshjet e huamarrjes, kërkesat rregullatore ose marrëveshjet kontraktuale midis investitorëve me kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi një sipërmarrje të përbashkët ose një pjesëmarrje) në aftësinë e sipërmarrjeve të përbashkëta ose pjesëmarrjeve për të transferuar fondet tek njësia ekonomike në formën e dividendëve në mjete monetare, ose për të shlyer kreditë apo paradhëniet e dhëna nga njësia ekonomike.

(b) kur pasqyrat financiare të një sipërmarrjeje të përbashkët ose pjesëmarrjeje, të përdorura gjatë zbatimit të metodës së kapitalit neto, kanë një datë ose një periudhë të ndryshme nga ajo e njësisë ekonomike:

(i) datën e mbarimit të periudhës së raportimit të pasqyrave financiare të kësaj sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrjeje; dhe

(ii) arsyen e përdorimit të një date apo periudhe të ndryshme.

(c) pjesën e panjohur të humbjeve të një sipërmarrjeje të përbashkët ose pjesëmarrjeje, si për periudhën raportuese dhe në mënyrë kumulative, nëse njësia ekonomike ka ndaluar njohjen e

 © Fondacioni i SNRF-ve

pjesës së saj të humbjeve në sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrjen, kur zbaton metodën e kapitalit neto.

Rreziqet që lidhen me interesat e një njësie ekonomike në sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet

23 Njësia ekonomike jep si informacion shpjegues:

(a) angazhimet që ajo ka në lidhje me sipërmarrjet e saj të përbashkëta, të paraqitura veçmas nga shuma e angazhimeve të tjera, ashtu siç përcaktohet në paragrafët B18–B20.

(b) detyrimet e kushtëzuara të shkaktuara nga interesat e saj në sipërmarrjet e përbashkëta apo pjesëmarrjet (duke përfshirë pjesën e saj të detyrimeve të kushtëzuara së bashku me atë të investitorëve të tjerë që kanë kontroll të përbashkët, ose influencë të konsiderueshme në sipërmarrjet e përbashkëta ose pjesëmarrjet), duke i paraqitur veçmas nga shuma e detyrimeve të tjera të kushtëzuara, në përputhje me SNK 37 *Provizionet, detyrimet dhe aktivet e kushtëzuara*, me përjashtim të rastit kur probabiliteti i humbjes është i ulët.

Interesat në njësitë e strukturuara e të pakonsoliduara

24 Një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese që u mundëson përdoruesve të pasqyrave të saj financiare:

(a) të kuptojnë natyrën dhe shtrirjen e interesave të saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara (paragrafët 26-28); dhe

(b) të vlerësojë natyrën e rreziqeve që lidhen me interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pa konsoliduara, dhe ndryshimet në to (paragrafët 29-31).

25 Informacioni i kërkuar nga paragrafi 24 (b) përfshin informacionin rreth ekspozimit të njësisë ekonomike ndaj rrezikut nga përfshirja që ajo ka pasur, në periudhat e mëparshme, me njësitë ekonomike të strukturuara e të pa konsoliduara (p.sh. sponsorizimi i njësisë ekonomike të strukturuar), edhe nëse njësia ekonomike nuk ka më ndonjë përfshirje kontraktuale me njësinë ekonomike të strukturuar, në datën e raportimit.

25A Një njësi ekonomike investuese nuk i kërkohet të japë informacione shpjeguese sipas paragrafëve 24 për një njësi ekonomike të strukturuar që ajo kontrollon dhe për të cilën ajo paraqet informacione shpjeguese që kërkohen nga paragrafët 19A-19G.

Natyra e interesave

26 Një njësi ekonomike jep informacion shpjegues cilësor dhe sasior në lidhje me interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pa konsoliduara, duke përfshirë, por jo vetëm, natyrën, qëllimin, madhësinë dhe aktivitetet e njësisë ekonomike të strukturuar dhe mënyrën sesi njësia ekonomike e strukturuar është financuar.

27 Nëse një njësi ekonomike ka sponsorizuar një njësi ekonomike të strukturuare të pa konsoliduar, për të cilën ajo nuk jep informacion siç kërkohet nga paragrafi 29 (p.sh. për shkak se ajo nuk ka një interes në njësinë ekonomike në datën e raportimit), njësia ekonomike jep informacione shpjeguese:

(a) se si ajo e ka përcaktuar se cilën prej njësive të strukturuara të sponsorizojë;

(b) *të ardhurat nga këto njësi ekonomike të strukturuara*, gjatë periudhës së raportimit, duke përfshirë një përshkrim të llojeve të ardhurave të paraqitura; dhe

(c) vlerën kontabël (në kohën e transferimit) të gjitha aktiveve të transferuara në këto njësi ekonomike të strukturuara gjatë periudhës raportuese.

28 Një njësi ekonomike do ta paraqesë informacionin sipas paragrafit 27 (b) dhe (c) në formë tabelore, me përjashtim të rastit kur është më i përshtatshëm një format tjetër, dhe do të klasifikojë aktivitetet e saj të sponsorizimit në kategoritë përkatëse (shih paragrafët B2-B6).

Natyra e rreziqeve

29 Një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese në formë tabelore, me përjashtim të rastit kur është më i përshtatshëm një format tjetër, duke bërë një përmbledhje të:

(a) vlerave kontabël të aktiveve dhe pasiveve, të njohura në pasqyrat e saj financiare, që lidhen me interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pa konsoliduara.

(b) nën zërave në pasqyrën e pozicionit financiar, në të cilën janë njohur këto aktive dhe detyrime.

(c) shumës që përfaqëson më mirë ekspozimin maksimal të njësisë ekonomike ndaj humbjes nga interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara, duke përfshirë edhe se si është përcaktuar ekspozimi maksimal ndaj humbjes. Nëse një njësi ekonomike nuk mund të përcaktojë nga pikëpamja sasiore ekspozimin e saj maksimal ndaj humbjes nga interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara, ajo do të japë informacione shpjeguese për këtë fakt si dhe arsyet.

(d) një krahasim të vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të njësisë ekonomike, që lidhen me interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara, dhe ekspozimit maksimal të njësisë ekonomike ndaj humbjes nga këto njësi.

30 Nëse gjatë periudhës raportuese një njësi ekonomike, pa pasur ndonjë detyrim kontraktual, i ka dhënë mbështetje financiare apo mbështetje tjetër një njësie ekonomike të strukturuar e të pa konsoliduar, në të cilën ka pasur më parë ose ka, aktualisht, një interes (për shembull, blerjen e aktiveve ose instrumenteve të emetuara nga njësia ekonomike e strukturuar), njësia ekonomike jep informacion shpjegues për:

(a) llojin dhe madhësinë e mbështetjes së dhënë, përfshirë situatat në të cilat njësia ekonomike ka ndihmuar njësinë e strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare; dhe

(b) arsyet për dhënien e mbështetjes.

31 Njësia ekonomike do të japë informacion shpjegues për çdo synim aktual për t'i dhënë mbështetje financiare apo mbështetje tjetër një njësie ekonomike të strukturuar e të pa konsoliduar, duke përfshirë synimet për të ndihmuar njësinë ekonomike të strukturuar në marrjen e mbështetjes financiare.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojca A
Termat e përkufizuara

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së

të ardhurat nga një njësi ekonomike e strukturuar

Për qëllime të këtij SNRF-je, të ardhurat nga një **njësi ekonomike e strukturuar** përfshijnë, por jo vetëm, tarifat periodike dhe jo periodike, interesat, dividendët, fitimet ose humbjet neto nga ri matja ose çregjistrimi i interesave të njësive ekonomike të strukturuara dhe fitimet ose humbjet neto nga transferimi i aktiveve dhe i detyrimeve në njësinë ekonomike të strukturuar.

interesi në një njësi tjetër ekonomike

Për qëllime të këtij SNRF-je, një interes në një njësi tjetër ekonomike i referohet përfshirjes kontraktuale dhe jo-kontraktuale që e ekspozon një njësi ekonomike ndaj ndryshueshmërisë të kthimeve nga performanca e njësisë tjetër ekonomike. Një interes në një njësi tjetër ekonomike mund të evidentohet, por jo vetëm, nga mbajtja e instrumenteve të kapitalit neto apo të borxhit, si dhe format e tjera të përfshirjes të tilla si sigurimi i fondeve, mbështetje likuiditeti, mbajtja e aktivit si garanci kredie dhe garancitë. Ai përfshin mjetet me të cilat një njësi ekonomike ka kontroll ose kontroll të përbashkët ose influencë të konsiderueshme mbi një njësi tjetër ekonomike. Nuk është e thënë që një njësi ekonomike të ketë një interes në një njësi tjetër ekonomike vetëm për shkak të një marrëdhënie tipike furnitor - klient.

Paragrafët B7–B9 japin informacion të mëtejshëm rreth interesave në njësitë e tjera ekonomike.

Paragrafët B55-B57 të SNRF 10 shpjegojnë ndryshueshmërinë e kthimeve.

njësi ekonomike e strukturuar

Një njësi ekonomike, e përcaktuar në mënyrë që të drejtat e votës apo të ngjashme me to nuk përbëjnë faktor dominues në përcaktimin se kush e kontrollon njësinë ekonomike, si në rastin kur të gjitha të drejtat e votës lidhen vetëm me detyrat administrative dhe aktivitetet përkatëse drejtohen nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale.

Paragrafët B22-B24 japin informacionin e mëtejshëm rreth njësive ekonomike të strukturuara.

Termat e mëposhtëm janë përcaktuar në SNK 27 (i rishikuar në 2011), SNK 28 (i rishikuar në 2011), SNRF 10 dhe SNRF 11 *Marrëveshjet e përbashkëta* dhe janë përdorur në këtë SNRF me kuptimet e specifikuara në këto SNRF:

- pjesëmarrje
- pasqyra financiare të konsoliduara
- kontroll i një njësie ekonomike
- metoda e kapitalit neto
- grup
- njësi ekonomike investuese
- marrëveshje e përbashkët
- kontroll i përbashkët
- operacion i përbashkët
- sipërmarrje e përbashkët
- interes jo kontrollues
- shoqëria mëmë
- të drejtat mbrojtëse
- veprimtari përkatëse
- pasqyra financiare individuale
- mjet financiar i veçantë
- influencë e konsiderueshme

- filial.

 © Fondacioni i SNRF-ve

Shtojca B
Udhëzim për zbatim

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-së Ajo përshkruan zbatimin e paragrafëve 1-31 dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.

B1 Shembujt në këtë shtojcë karakterizojnë situata hipotetike. Edhe pse disa aspekte të shembujve mund të jenë të pranishme në modelet aktuale faktike, kur të zbatohet SNRF 12 do të ishte e nevojshme të vlerësoheshin të gjitha faktet dhe rrethanat përkatëse të një modeli të veçantë faktik.

Totalizimi (paragrafi 4)

B2 Një njësi ekonomike do të vendosë, në varësi të rrethanave të saj, se sa informacion të hollësishëm duhet të japë për të plotësuar nevojat e përdoruesve, çfarë theksi do t'iu verë aspekteve të ndryshme të kërkesave dhe se si do ta totalizojë informacionin. Është e nevojshme të arrihet një ekuilibër midis rëndimit të pasqyrave financiare me hollësira të tepërta, që mund të mos i ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare, dhe bërjes së informacionit të pakuptueshëm si pasojë e totalizimit.

B3 Një njësi ekonomike mund të japë në total informacione shpjeguese, të kërkuara nga ky SNRF, për interesa në njësi ekonomike të ngjashme, nëse totalizimi është në përputhje me objektivin e dhënies së informacionit shpjegues dhe kërkesat në paragrafin B4, dhe nuk e bën të pakuptueshëm informacionin e dhënë. Një njësi ekonomike jep informacion shpjegues se si ajo i ka totalizuar interesat e saj në njësitë ekonomike të ngjashme.

B4 Një njësi ekonomike do të paraqesë informacion të veçantë për interesat në:

(a) filialet;

(b) sipërmarrjet e përbashkëta;

(c) operacionet e përbashkëta;

(d) pjesëmarrjet; dhe

(e) njësitë ekonomike të strukturuara e të pa konsoliduara.

B5 Për të bërë totalizimin e informacionit, një njësi ekonomike do të marrë parasysh informacionin sasior dhe cilësor në lidhje me karakteristikat e ndryshme të rrezikut dhe të kthimit të çdo njësie ekonomike, që është përcaktuar për totalizim si dhe rëndësinë që ka çdo njësi e tillë për njësinë raportuese. Njësia ekonomike do ta paraqesë informacionin shpjegues, në një mënyrë të tillë, që i sqaron qartë përdoruesit e pasqyrave financiare në lidhje me natyrën dhe shtrirjen e interesave të saj në këto njësi të tjera ekonomike.

B6 Shembuj të niveleve të totalizimit, që mund të jenë të përshtatshëm brenda klasave të njësive ekonomike të përcaktuara në paragrafin B4, janë:

(a) natyra e veprimtarive (p.sh. një njësi ekonomike për kërkim dhe zhvillim, një njësi ekonomike që merret me krijim kartash kredie të përsëritshme).

(b) klasifikimi i industrisë.

(c) gjeografia (p.sh. vendi ose rajoni).

Interesat në njësitë e tjera ekonomike

B7 Një interes në një njësi tjetër ekonomike i referohet përfshirjes kontraktuale dhe jo-kontraktuale që e ekspozon njësinë ekonomike raportuese ndaj ndryshueshmërisë së kthimit nga performanca e njësisë tjetër ekonomike. Shqyrtimi i qëllimit dhe përcaktimi i njësisë tjetër ekonomike mund ta ndihmojë njësinë ekonomike raportuese gjatë vlerësimit që ajo bën nëse ka një interes në këtë njësi, dhe si rrjedhim, nëse është e nevojshme të japë informacione shpjeguese sipas këtij SNRF-je. Ky vlerësim do të përfshijë shqyrtimin e rreziqeve që mendohen të krijohen nga njësia tjetër ekonomike dhe rreziqet e kësaj njësie që mendohen t'i kalohen njësisë raportuese dhe palëve të tjera.

B8 Një njësi raportuese është e ekspozuar, në mënyrë tipike, ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga performanca e një njësie tjetër ekonomike nëpërmjet mbajtjes së instrumenteve (të tilla si instrumente të kapitalit apo instrumente borxhi të emetuara nga njësia tjetër ekonomike) ose duke patur një përfshirje tjetër që e absorbon ndryshueshmërinë. Për shembull, supozojmë një njësi ekonomike të strukturuar që zotëron

një portofol kredie. Njësia e strukturuar siguron një kontratë shkëmbimi për mos shlyerje kredie nga një tjetër njësi ekonomike (njësia raportuese) për të mbrojtur veten nga vonesa e pagesave të interesit dhe principalit të borxheve. Njësia raportuese ka një përfshirje që e ekspozon atë ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga performanca e njësisë ekonomike të strukturuar, sepse derivativi i mos shlyerjes së kredisë absorbon ndryshueshmërinë e kthimeve të njësisë ekonomike të strukturuar.

B9 Disa instrumente janë të përcaktuara për të transferuar rrezikun nga një njësi raportuese në një njësi tjetër ekonomike. Instrumente të tilla krijojnë ndryshueshmëri të kthimeve për njësinë tjetër ekonomike, por zakonisht nuk e ekspozojnë njësinë raportuese ndaj ndryshueshmërisë së kthimeve nga performanca e njësisë tjetër ekonomike. Për shembull, supozojmë se një njësi ekonomike e strukturuar është krijuar për të ofruar mundësi investimi për investitorët të cilët dëshirojnë të jenë të ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë të njësisë Z (njësia ekonomike Z nuk ka lidhje me ndonjë palë të përfshirë në marrëveshje). Njësia ekonomike e strukturuar merr fonde duke i'u emetuar investitorëve dëftesa që janë të lidhura me rrezikun e kredisë të njësisë Z (dëftesa të lidhura me kredinë) dhe i përdor të ardhurat për t'i investuar në një portofol aktivesh financiare pa rrezik. Njësia ekonomike e strukturuar merr përsipër ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë të njësisë Z, duke hyrë në një marrëveshje derivativi për mos shlyerje kredie (CDS) me një palë tjetër. CDS ia kalon rrezikun e njësisë ekonomike Z njësisë së strukturuar në këmbim të një tarifë të paguar nga pala tjetër. Investitorët në njësinë ekonomike të strukturuar marrin një kthim më të lartë, që pasqyron si kthimin e njësisë së strukturuar nga portofoli i saj i aktiveve, ashtu dhe tarifën e CDS-së. Pala tjetër e marrëveshjes nuk ka përfshirje me njësinë ekonomike të strukturuar që ta ekspozojë atë ndaj ndryshueshmërisë së kthimit nga performanca e njësisë ekonomike të strukturuar, sepse CDS transferon ndryshueshmërinë tek njësia ekonomike e strukturuar, në vend që të absorbojë ndryshueshmërinë e kthimeve të njësisë ekonomike të strukturuar.

Informacioni financiar përmbledhës për filialet, sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet (paragrafët 12 dhe 21)

B10 Për çdo filial që ka interesa jo-kontrolluese që janë materiale për njësinë ekonomike raportuese, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për:

(a) dividendët e paguar për interesat jo-kontrolluese.

(b) informacionin përmbledhës financiar për aktivet, detyrimet, fitimin ose humbjen dhe flukset monetare të filialit që i mundëson përdoruesit të kuptojnë interesin që kanë interesat jo-kontrolluese në veprimtaritë e grupit dhe flukset monetare. Ky informacion mund të përfshijë, por jo vetëm, për shembull, aktivet afatshkurtra, aktivet afatgjata, detyrimet afatshkurtra, detyrimet afatgjata, të ardhurat, fitimin ose humbjen dhe totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse.

B11 Informacioni përmbledhës financiar, i kërkuar nga paragrafi B10(b), do të jetë në lidhje me shumat para se të bëhen eliminimet midis shoqërive.

B12 Për çdo sipërmarrje të përbashkët dhe pjesëmarrje, që është materiale për njësinë ekonomike raportuese, njësia ekonomike jep informacione shpjeguese për:

(a) dividendët e marrë nga sipërmarrjet e përbashkëta ose pjesëmarrjet.

(b) informacionin përmbledhës financiar për sipërmarrjet e përbashkëta ose pjesëmarrjet (shih paragrafët B14 dhe B15), duke përfshirë, por pa qenë e nevojshme të kufizohet:

(i) aktivet afatshkurtra.

(ii) aktivet afatgjata.

(iii) detyrimet afatshkurtra.

(iv) detyrimet afatgjata.

(v) të ardhurat.

(vi) fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme.

(vii) fitimin ose humbjen pas tatimit, nga operacionet jo të vijueshme.

(viii) të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

(ix) totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse.

B13 Përveç informacionit përmbledhës financiar të kërkuar nga paragrafi B12, një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për çdo sipërmarrje të përbashkët, që është materiale për njësinë raportuese, në lidhje me shumën e:

(a) mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre të përfshira në paragrafin B12(b)(i).

 © Fondacioni i SNRF-ve

(b) detyrimeve afatshkurtra financiare (duke përjashtuar llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogaritë e tjera të pagueshme si dhe provizionet), të përfshira në paragrafin B12(b)(iii).

(c) detyrimeve afatgjata financiare (duke përjashtuar llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogaritë e tjera të pagueshme si dhe provizionet), të përfshira në paragrafin B12(b)(iv).

(d) amortizimit.

(e) të ardhurave nga interesi.

(f) shpenzimeve të interesit.

(g) shpenzimeve të tatimeve mbi të ardhurat ose tatimi mbi të ardhurat.

B14 Informacione financiare përmbledhëse, të dhëna si informacion shpjegues në përputhje me paragrafët B12 dhe B13, do të jenë shumat e përfshira në pasqyrat financiare, të ndërtuara sipas SNRF-ve, të sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes (dhe jo pjesa e njësisë ekonomike në këto shuma). Nëse njësia ekonomike e kontabilizon interesin e saj në sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrje duke përdorur metodën e kapitalit neto:

(a) shumat e përfshira në pasqyrat financiare, të ndërtuara sipas SNRF-ve, të sipërmarrjes së përbashkët ose pjesëmarrjes, do të rregullohen për të pasqyruar rregullimet e bëra nga njësia ekonomike kur përdor metodën e kapitalit neto, të tilla si rregullimet e vlerës së drejtë të bëra në kohën e blerjes dhe rregullimet për ndryshimet në politikat kontabël.

(b) njësia ekonomike do të bëjë një rakordim të informacionit përmbledhës financiar dhënë si informacion shpjegues me vlerën kontabël (neto) të interesit të saj në sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrjen.

B15 Një njësi ekonomike mund të paraqesë informacionin përmbledhës financiar, të kërkuar nga paragrafët B12 dhe B13, në bazë të pasqyrave financiare të sipërmarrjes së përbashkët ose të pjesëmarrjes, nëse:

(a) njësia ekonomike mat interesin e saj në sipërmarrjen e përbashkët ose pjesëmarrje me vlerën e drejtë, në përputhje me SNK 28 (i ndryshuar në 2011); dhe

(b) sipërmarrja e përbashkët ose pjesëmarrja nuk i përgatit pasqyrat financiare sipas SNRF-ve dhe përgatitja mbi këtë bazë do të ishte e pamundur ose do të shkaktonte kosto të panevojshme.

Në këtë rast, njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese për bazën mbi të cilën është përgatitur informacioni përmbledhës financiar.

B16 Një njësi ekonomike jep informacion shpjegues, në total, për vlerën kontabël të interesave të saj në të gjitha sipërmarrjet e përbashkëta ose pjesëmarrjet, individualisht jomateriale, që kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto. Njësia ekonomike do të japë informacione shpjeguese, veçmas, për shumën totale, në ato 'sipërmarrje të përbashkëta' ose 'pjesëmarrje', të pjesës së saj në:

(a) fitimin ose humbjen nga operacionet e vazhdueshme.

(b) fitimin ose humbjen pas tatimit, nga operacionet jo të vijueshme.

(c) të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

(d) totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese veçmas për sipërmarrjet e përbashkëta dhe pjesëmarrjet.

B17 Kur interesi i një njësie ekonomike në një filial, në një sipërmarrje të përbashkët ose në një pjesëmarrje (ose një pjesë e interesit të saj në një sipërmarrje të përbashkët ose në një pjesëmarrje) është klasifikuar si i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5, nuk është e nevojshme që njësia ekonomike të japë informacion përmbledhës financiar për këtë filial, sipërmarrje të përbashkët ose pjesëmarrje në përputhje me paragrafët B10–B16.

Angazhimet në lidhje me sipërmarrjet e përbashkëta(paragrafi 23(a))

B18 Një njësi ekonomike jep informacione shpjeguese për tërësinë e angazhimeve që ka bërë, por që nuk i ka njohur në datën e raportimit (duke përfshirë pjesën e saj të angazhimeve të bëra së bashku me investitorët e tjerë me kontroll të përbashkët të një sipërmarrjeje të përbashkët) në lidhje me interesat e saj në sipërmarrjet e përbashkëta. Angazhime janë ato që mund të çojnë në një dalje të ardhshme të mjeteve monetare ose burimeve të tjera.

B19 Angazhimet e panjohura që mund të çojnë në një dalje të ardhshme të mjeteve monetare ose burimeve të tjera përfshijnë:

(a) angazhime të panjohura për të kontribuar në financime apo burime, për shembull, si rezultat i:

(i) marrëveshjeve ligjore apo të blerjes së një sipërmarrje të përbashkët (e cila, për shembull, kërkon që një njësi ekonomike të kontribuojë me fonde për një periudhë të caktuar).

(ii) projekteve me kapital intensiv të ndërmarra nga një sipërmarrje e përbashkët.

(iii) detyrimeve të pakushtëzuara të blerjes, prokurimit të përbërë të pajisjeve, inventarit ose shërbimeve që një njësi ekonomike është e angazhuar për të blerë nga, ose në emër të një sipërmarrjeje të përbashkët.

(iv) angazhimeve të panjohura për të siguruar kredi ose mbështetje tjetër financiar për një sipërmarrje të përbashkët.

(v) angazhimeve të panjohura për të kontribuar me burime si aktive apo shërbime, në një sipërmarrje të përbashkët.

(vi) angazhimeve të tjera të paanullueshme, të panjohura, në lidhje me një sipërmarrje të përbashkët.

(b) angazhime të panjohura për të blerë interesin e pronësisë të palës tjetër (ose një pjesë të këtij interesi të pronësisë) në një sipërmarrje të përbashkët, në qoftë se një ngjarje e veçantë ndodh apo nuk ndodh në të ardhmen.

B20 Kërkesat dhe shembujt në paragrafët B18 dhe B19 ilustrojnë disa prej llojeve të shpjegimeve që duhet të jepen sipas paragrafit 18 të SNK 24 *Dhënia e informacioneve Shpjeguese në lidhje me palët e lidhura.*

Interesat në njësitë e strukturuara të pakonsoliduara(paragrafët 24–31)

Njësitë ekonomike të strukturuara

B21 Një njësi ekonomike e strukturuar është një njësi ekonomike në të cilën të drejtat e votës ose të drejtat e ngjashme me to nuk janë faktor dominues në përcaktimin se kush kontrollon njësinë ekonomike, të tilla si në rastin kur të gjitha të drejtat e votës kanë të bëjnë vetëm me detyrat administrative, ndërsa veprimtaritë përkatëse janë të drejtuara me anën e marrëveshjeve kontraktuale.

B22 Një njësi ekonomike e strukturuar shpesh ka disa ose të gjitha karakteristikat apo cilësitë e mëposhtme:

(a) veprimtari të kufizuara.

(b) një objektiv të ngushtë dhe të mirë-përcaktuar, të tillë si të japë me qira në mënyrë efikase nga pikëpamja tatimore, të kryejë veprimtari kërkim- zhvillimi, të sigurojë një burim kapitali ose financimi për një njësi ekonomike ose të ofrojë mundësi investimi për investitorët duke ua kaluar atyre rreziqet dhe përfitimet që lidhen me aktivet e njësisë ekonomike të strukturuar.

(c) kapital të pamjaftueshëm që ta lejojë njësinë ekonomike të strukturuar të financojë veprimtaritë e saj pa qenë e varur nga mbështetja financiare.

(d) financim në formën e instrumenteve të shumtë, të lidhur në mënyrë kontraktuale me investitorët, që krijojnë përqendrime të rreziqeve të kredisë ose rreziqeve të tjera (të kësteve).

B23 Shembuj, por pa u kufizuar vetëm në to, të njësive ekonomike që konsiderohen si njësi ekonomike të strukturuara përfshijnë:

(a) mekanizmat e procesit të krijimit të letrave me vlerë.

(b) financimet e mbështetura në aktive.

(c) disa fonde të investimeve.

B24 Një njësi ekonomike, që kontrollohet nëpërmjet të drejtave të votës, nuk është një entitet i strukturuar thjesht sepse, për shembull, ajo merr fonde nga palët e treta pas një ristrukturimi.

Natyra e rreziqeve nga interesat në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara (paragrafët 29–31)

B25 Përveç informacionit të kërkuar nga paragrafët 29–31 një njësi ekonomike do të japë informacion shpjegues shtesë që është i nevojshëm për të realizuar objektivin e dhënies së informacioneve shpjeguese në paragrafin 24(b).

 © Fondacioni i SNRF-ve

B26 Në varësi të rrethanave, shembuj të informacionit shtesë, që mund të jetë i rëndësishëm për vlerësimin e rreziqeve ndaj të cilave është e ekspozuar një njësi ekonomike, kur ajo ka një interes në një njësi të strukturuar e të pa konsoliduar, janë:

(a) kushtet e një marrëveshje, të cilat mund të kërkojnë që njësia ekonomike t'i japë mbështetje financiare një njësie ekonomike të strukturuar e të pa konsoliduar (p.sh. marrëveshje e likuiditetit ose rishikimet e vlerësimit të kredisë të lidhura me detyrimet për të blerë aktivet e njësisë ekonomike të strukturuar apo për të dhënë mbështetje financiare), përfshijnë:

(i) një përshkrim të ngjarjeve ose rrethanave që mund ta ekspozojnë njësinë raportuese ndaj një humbjeje.

(ii) nëse ka ndonjë kusht që do të kufizonte detyrimin.

(iii) nëse ka ndonjë palë tjetër që ofron mbështetje financiare dhe, nëse po, si renditet detyrimi i njësisë ekonomike raportuese kundrejt atyre të palëve të tjera.

(b) humbjet e pësuara nga njësia ekonomike gjatë periudhës raportuese në lidhje me interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara.

(c) llojet e të ardhurave që njësia ekonomike ka marrë gjatë periudhës raportuese nga interesat e saj në njësitë ekonomike të strukturuara e të pakonsoliduara.

(d) nëse njësia ekonomike kërkohet të absorbojë humbjet e një njësie ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar përpara palëve të tjera, afatin maksimal të humbjeve të tilla për njësinë ekonomike dhe (nëse është e rëndësishme) klasifikimin dhe shumën e humbjeve të mundshme që mbulohen nga palët, interesat e të cilave klasifikohen në një nivel më të ulët se interesi i njësisë ekonomike në njësinë e strukturuar të pa konsoliduar.

(e) informacionin për çdo marrëveshje likuiditeti, garancitë ose angazhimet e tjera me palët e treta që mund të ndikojnë në vlerën e drejtë ose rrezikun e interesave të njësisë ekonomike në njësitë ekonomike të strukturuara të pakonsoliduara.

(f) çdo vështirësi që një njësi ekonomike e strukturuar dhe e pa konsoliduar ka përjetuar në financimin e veprimtarive të saj gjatë periudhës raportuese.

(g) format e financimit (p.sh. dëftesat tregtare apo dëftesat afatmesme) dhe jetën mesatare të ponderuar të tyre, në rastin e financimit të një njësie ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar. Ky informacion mund të përfshijë analiza të maturimit të aktiveve dhe të financimit të një njësie ekonomike të strukturuar të pa konsoliduar, nëse kjo njësi ka aktive afatgjata të financuara nga financimet afatshkurtra.

Shtojca C
Data e hyrjes në fuqi dhe dispozita kalimtare

Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF-ve dhe ka të njëjtin autoritet si pjesët e tjera të SNRF-së.

Data e hyrjes në fuqi dhe periudha kalimtare

C1 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë SNRF për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Lejohet aplikimi më i hershëm.

C1A *Pasqyrat e konsoliduara financiare, Marrëveshjet e përbashkëta dhe deklarimin e interesave të subjekteve të tjera: Udhëzime Tranzicioni* (Ndryshimet në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12), të publikuara në qershor 2012, shtuan paragrafët C2A–C2B. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2013. Nëqoftëse njësia ekonomike zbaton SNRF 12 në një periudhë të mëparshme, këto ndryshime zbatohen për atë periudhë të mëparshme.

C1B *Njësitë ekonomike investuese* (ndryshimet për SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 27), publikuar në tetor 2012, kanë ndryshuar paragrafin 2 dhe Shtojcën A dhe ka shtuar paragrafët 9A-9B, 19A-19G, 21A dhe 25A. Një njësi ekonomike do të aplikojë këto ndryshime për periudhat vjetore që fillojnë në ose pas datës 1 janar 2014. Lejohet aplikimi më i hershëm. Në qoftë se një njësi ekonomike aplikon më herët këto ndryshime, ajo duhet të japë informacion shtesë për këtë fakt dhe të aplikojë të gjitha ndryshimet e përfshira në *Njësitë ekonomike investuese* në të njëjtën kohë.

C1C *Njësitë ekonomike investuese: Zbatimi i përjashtimit në konsolidim* (Ndryshime në SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28), i publikuar në dhjetor 2014, ndryshoi paragrafin 6. Njësia ekonomike do ta zbatojë këtë ndryshim për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2016 ose më pas. Lejohet aplikimi më i hershëm. Nëse një njësi ekonomike zbaton ndryshimin për një periudhë më të hershme, ajo duhet të japë informacione shpjeguese për këtë fakt.

C1D *Përmirësime vjetore të SNRF-ve Cikli 2014-2016, t*ë publikuara në dhjetor 2016, kanë shtuar paragrafin 5A dhe kanë ndryshuar paragrafin B17. Një njësi ekonomike do të aplikoj këto ndryshime në mënyrë retrospektive në përputhje me SNK 8 *Politikat kontabël, ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet*[1] për periudhat vjetore që fillojnë ne 1 janar 2017 e në vazhdim.

C1E SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* i publikuar në prill 2024 ndryshoi paragrafin B14. Njësia ekonomike duhet të zbatojë këto ndryshime, kur zbaton SNRF 18.

C2 Një njësi ekonomike inkurajohet të japë informacionin e kërkuar nga ky SNRF më herët se sa periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 e në vijim. Dhënia e disa prej informacioneve shpjeguese të kërkuara nga ky SNRF nuk e detyron njësinë ekonomike të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat e këtij SNRF-je ose të zbatojë SNRF 10, SNRF 11, SNK 27 (i ndryshuar në 2011) dhe SNK 28 (i ndryshuar në 2011) përpara kësaj date.

C2A Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese të kësaj SNRF nuk duhet të zbatohet për çdo periudhë të paraqitur që fillon menjëherë para periudhës së parë vjetore për të cilën SNRF 12 është aplikuar.

C2B Kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese për paragrafët 24-31 dhe udhëzuesin korrespondues B21–B26 i kësaj SNRF nuk duhet të aplikohet për çdo periudhë të paraqitur që fillon para periudhës së parë vjetore për të cilën SNRF 12 është aplikuar.

Referencat në SNRF 9

C3 Nëse një njësi ekonomike e zbaton këtë SNRF, por ende nuk zbaton SNRF 9, çdo referencë në SNRF 9 do të lexohet si një referencë në SNK 39 *Instrumentet financiarë: Njohja dhe matja.*

[1] Kur publikoi SNRF 18 *Paraqitja dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese në Pasqyrat Financiare* në prill 2024, BSNK ndryshoi titullin e SNK 8 në *Baza e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare*.

 © Fondacioni i SNRF-ve